



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE  
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBBIMIN CIVIL

Nr. 2366/14 prot.

Tiranë, më 09.07.2020

Lënda: Njoftim me shpallje publike

**ZNJ. MIGENA REÇI**

**Tiranë**

Bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në zbatim të pikës 5, të Kreut VII, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, si dhe në vijim të shkresës nr. 2283 prot., datë 29.5.2020 të Ministrisë së Kulturës, me lëndë “Kërkesë për lirim të Anëtarit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues nga një pozicion i rregullt drejtues”, Departamenti i Administratës Publike ka nxjerrë aktin nr. 2366/1 prot., datë 08.06.2020, për lirim tuaj nga pozicioni i rregullt drejtues i anëtarit të TND-së, në Ministrinë e Kulturës.

Rezulton se, posta shqiptare ka kthyer në mënyrë të përsëritur aktin tuaj të lirim me shënimin “Marrësi nuk është në adresë në momentin e dorëzimit”. Meqenëse njoftimi nuk është i mundur, si dhe çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur, në zbatim të nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vendosëm të procedojmë me njoftimin publik me shpallje të aktit të lirim dhe dokumentacionit shoqërues, respektivisht në faqen e internetit të DAP-it, në një kënd të posaçëm pranë këtij institucioni, pranë Administratës së Prefektit të Qarkut Tiranë, si dhe në njësinë administrative ku rezulton vendbanimi juaj.

Sa më lart, afishojmë njoftimin publik me shpallje në këndin e institucionit të DAP-it, për një afat 10-ditor, nga data 6.7.2020, deri në datën 16.7.2020.

**DREJTOR DEPARTAMENTI**  
**Albana Koçiu**



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE  
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Nr. 2366 / prot.

Tiranë, më 08.06.2020

Lënda: Lirim nga pozicioni i rregullt drejtues i anëtarit të TND

**ZNJ. MIGENA REÇI**  
**Anëtar i TND-së**

**Tiranë**

Bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në zbatim të pikës 5, të Kreut VII, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", i ndryshuar, si dhe në vijim të shkresës nr. 2283 prot., datë 29.5.2020 të Ministrisë së Kulturës, me lëndë "Kërkesë për lirimin e Anëtarit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues nga një pozicion i rregullt drejtues", për znj. Migena Reçi, protokolluar pranë Departamentit të Administratës Publike me nr. 2366 prot., datë 3.6.2020,

- **Znj. Migena Reçi** lirohet nga pozicioni Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Kulturën, në Ministrinë e Kulturës.

**DREJTOR DEPARTAMENTI**  
**Albana Koçiu**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE  
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Nr. 2366 prot.

Tiranë, më 08.06.2020

Lënda: Kthim përgjigje suajës nr. 2283 prot., datë 29.5.2020

**MINISTRISË SË KULTURËS**

**Sekretarit të Përgjithshëm**

**Tiranë**

**ZNJ. MIGENA REÇI**

**Tiranë**

Në vijim të shkresës nr. 2283 prot., datë 29.5.2020, të Ministrisë së Kulturës, me lëndë "Kërkesë për lirim të Anëtarit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues nga një pozicion i rregullt drejtues", gjeni bashkëlidhur aktin e lirimit nga pozicioni Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Kulturën, në Ministrinë e Kulturës, të znj. Migena Reçi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR DEPARTAMENTI**  
**Albana Koçiu**